

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SEKTORI I KOORDINIMIT NDËRKOMBËTAR PROJEKTEVE DHE KËRKIMIT
SHKENCOR

Nr. 2629 Prot.

Gjirokastër, më 24.12.2025

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jaho CANA



Lënda: Thirrje për aplikime për bursë mobiliteti për studentët

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në bashkëpunim me Universitetin Józef Goluchowski të Shkencave të Aplikuara, Poloni, në kuadër të programit Erasmus+, fton studentët e Departamentit të Infermierisë dhe Fakultetit Ekonomik, të aplikojnë për të përfituar një bursë për praktikë për semestrin e dytë të vitit akademik 2025 - 2026 në Józef Goluchowski të Shkencave të Aplikuara.

Në përfundim të mobilitetit studentët do të vijnë në studimet në universitetin e tyre të origjinës (UGJ). Ata nuk do të paguajnë tarifë shkollimi në universitetin pritës, por do të vazhdojnë të paguajnë tarifat që aplikohen në universitetin e tyre të origjinës (UGJ).

Numri i bursave të studimit – 2 (dy) studentë të Departamentit të Infermierisë dhe 2 (dy) studentë të Fakultetit Ekonomik.

Bursa përfshin:

Kompensimin mujor për të mbuluar akomodimin dhe dietën ditore;
Shpenzimet e udhëtimit në vlerën e biletës.

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

- të jenë studentë të ciklit të parë ose të dytë të studimeve;
- të jenë studentë të Departamentit të Infermierisë dhe Fakultetit Ekonomik;
- të zotërojnë njohuri të mira të gjuhës angleze.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Merita akademike;
- Kompetenca gjuhësore;
- Prioritet do t'u jepet studentëve që nuk kanë marrë pjesë më parë në mobilitet në të njëjtin cikël studimi;
- Prioritet do t'u jepet studentëve që u përkasin grupeve nga diversitete sociale

ekonomike, gjinore, racore, ngjyre, aftësi të kufizuara, etj.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Letër motivimi;
- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash;
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohjen e gjuhës angleze;
- Letër reference;
- Dokument që vërteton aftësinë e kufizuar (nëse ka);
- Dokument që vërteton që studenti është anëtar i komunitetit rom, egjiptian ose pakicave të tjera (nëse ka);
- Dokument që vërteton që studenti vjen nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike ose bursë nga shteti (nëse ka).

Për përzgjedhjen e studentëve do të ngrihet nga Rektori një komision *ad hoc* i cili vlerëson dokumentacionin e dorëzuar nga studentët.

Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor brenda datës 12.01.2026, ora 16:00.

Kandidatët fitues do të njoftohen prej Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor brenda datës 16.01.2026 ora 16:00 në adresën e tyre të email-it.

Kandidatët aplikues kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të komisionit *ad hoc* pranë Rektorit brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit.

Për më shumë informacion rreth mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit, kontaktoni me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.

Universiteti "Eqrem Çabej" ju uron suksese!

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj



Konceptoi: Irma Gjollëshi

